


JEMI PUNËTORË



SI BLETA

DEMOKRACIA NË SHKOLLËN TONË

ELTI (11), DELVINA K. (11), AVEA (12), BLEART TH. (11), ENIS (12), UJKAN (11), BUTRINT (11), EMA (11),
ELOIDA (11)

Shumë të dashur lexues, ne nxënësit e këtij grupi me shumë kënaqësi do t'iu informojmë më shumë rreth demokracisë. Po ashtu, do të keni mundësi të lexoni sesa në mënyrë demokratike funksionon shkolla jonë. Për më shumë, lexojeni artikullin

Në shoqëritë demokratike është shumë e rëndësishme pjesëmarrja dhe barazia. Falë këtyre dyjave zhvillohet edhe shoqëria. Që të ketë barazi, së pari duhet të ketë pjesëmarrje. Është pothuajse e pamundur të kemi njëherë barazi, e pastaj pjesëmarrje. Ky është të paktën mendimi ynë.

Shkolla jonë ka një numër të madh të nxënësve, të cilët trajtohen të gjithë në mënyrë të barabartë. Nuk ka ndodhur për asnjë moment të vetëm që ndonjëri nga nxënësit e shkollës të jetë më i dalluar sesa të tjerët. Të njëjtën gjë mund ta themi edhe për kryetarin e klasës, apo edhe të shkollës. Edhe pse ata janë në atë pozitë, asnjëherë nuk gëzojnë më shumë të drejta sesa ne, nxënësit e tjerë. Ata kanë më shumë

përgjegjësi se ne, por jo të drejta. Në një mënyrë apo në tjetrën, të gjithë nxënësit kontribuojmë në të mirë të shkollës sonë, këtij tempulli të dijes. Në koridoret e shkollës kemi të vendosura shumë vizatime, të cilat janë bërë me shumë mund dhe dashuri. Këto vizatime nuk janë të përfunduara nga një nxënës, por nga shumë prej tyre. Të gjithë nga pak e bëjmë shkollën vend më të ngrohtë. Për këtë arsye e thamë që pjesëmarrja dhe barazia janë të rëndësishme. Së pari, duhet të jesh pjesë e diçkaje, e pastaj të trajtohesh në mënyrë të barabartë. Nuk mund të trajtohesh në atë mënyrë, nëse nuk je pjesë e tij/saj. Kjo është shkolla jonë. Vendi më i dashur, ku ne i vendosim gurëthemel e diturisë.

Të gjitha gjërat që i cekëm më lart janë të lidhura ngushtë me demokracinë. Po të mos ishte vendi ynë vend demokratik, as shkolla jonë nuk do të mund të funksiononte në këtë mënyrë. Pra, demokracia ka vlerë shumë të madhe, sepse ajo na mundëson të gjithëve të vlerësohemi për punën që e bëjmë. Mirëpo, demokracia nuk përfundon me kaq. Ajo është shumë më e gjerë. Ajo shtrihet pothuajse në çdo kënd të botës dhe është një ndër sistemet më të dashura për popullin. Vendi ynë Kosova ka demokraci përfaqësuese, pasi që qytetarët mbi moshën 18 vjeçare zgjedhin deputetët, të cilët marrin vendime për të gjithë popullin.




Fytyrat e të së ardhmes sonë të ndritur



Dituria është baza e çdo sukcesi



Në demokraci nuk duhet të bëjmë dallime mes njëri-tjetrit



KUVENDI DHE LIGJET E MIRATUARA ATY

VILSON (11), IDEAL (11), EMIRA (11), YLL (11), DELVINA (11), KLEA (11), ARRITA (12), OLSA (11), JON (11), VALON (12)



Me shumë interesim dhe me shumë kënaqësi mësuar rreth Kuvendit. Meqë jemi gazetarë, këto informata po i ndajmë me ju

Në vitin 2009, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për



Mbrojtjen e Mjedisit. Sipas këtij ligji, qytetarët duhet të jenë të kujdesshëm dhe ta ruajnë ambientin. Ne mendojmë se miratimi i këtij ligji ishte mëse i nevojshëm për ne. Pse kështu?

Ne kemi mësuar edhe në shkollë se ajri që e thithim është gjëja primare për shëndetin tonë. E ajri asnjëherë nuk është i pastër në një ambient të papastër. Ky ajër shkon në mushkëritë tona. Besojmë që po e shihni edhe ju pse thamë se ky ligj është kaq i rëndësishëm. Këtë ligj e miratuan pikërisht 120 përfaqësuesit tanë shtetëror, të cilët njihen si deputetë.

Gjithsesi se ky nuk është ligji i vetëm që deputetët

kanë miratuar. Ata miratojnë edhe ligje të tjera, të cilat e lehtësojnë jetën tonë si qytetarë. Prandaj, janë kaq të rëndësishëm deputetët për jetën tonë. Kjo detyrë e miratimit të ligjeve njihet si funksioni legjislativ i Kuvendit. Por, Kuvendi ka edhe dy funksione të tjera. Është funksioni kontrollues, që nënkupton se deputetët përpos që e zgjedhin Qeverinë, ata edhe e kontrollojnë punën e saj. Si dhe funksioni i tretë është funksioni përfaqësues. Ne thamë se deputetët na përfaqësojnë neve. Pra, ata janë zëri ynë në Kuvend. Kuvendi është kaq i vlefshëm për jetën tonë sa ne jemi shumë të lumtur që e kemi një institucion kaq demokratik. Kjo është arsyeja pse kërkojmë nga ju qytetarë të dashur, që të jeni sa më demokratikë me njëri-tjetrin. Vetëm kështu do të kemi sukses.



Bashkimi sjell rezultate





Të gjithë e dijmë se fëmijët janë e ardhmja e vendit. Mirëpo, fëmijët e edukuar dhe të arsimuar mirë, mendojnë mirë dhe kur të rriten, zgjedhin përfaqësuesit e duhur

Ne si klasë jemi shumë punëtorë. Këtë mund ta keni parë edhe nga titulli i gazetës sonë, i cili është bazuar në tiparin tonë më të veçantë.

Ne duam gjithçka që ka të bëjë me mësimin dhe me diturinë. Gjithashtu, na pëlqen shumë të vizatojmë. Përmes vizatimeve, ne shprehim gjërat që i kemi mësuar. Këtë gjë e bëjmë në mënyrë sa më kreative. Edhe këtu në Punëtorinë „Demos-ti“ sot kemi vizatu-


ar. Dikush ka kontribuar në gazetë duke shkruajtur, e dikush duke vizatuar. Në këtë faqe të gazetës sonë, mund të shihni vizatime të ndryshme, të cilat janë të punuara nga grupe të ndryshme. Mirëpo, mos harroni se kjo nuk është e tëra. Ne kemi edhe plot vizatime të tjera, të cilat mund t'i gjeni në: www.demos-ti.org. Ju ftojmë që ta vizitoni këtë faqe dhe të informoheni akoma më shumë. Ju faleminderit!



Këto janë duart tona. Me këto duar, ne do të ndërtojmë demokracinë dhe shtetin tonë. Këtë do ta bëjmë përmes votës, sepse ne jemi ata të cilët udhëheqim në demokraci

ZGJEDHJET, THEMEL I DEMOKRACISË

ARDIAN (11), ALTIN (11), BLEART (11), VESA (11), AULONA (11), RRONA (11), ORHIDEA (11), ANDI (12),
ALAUDIN (12)



Ne, nxënësit nga Gjakova, jemi shumë të gëzuar që patëm mundësi të jemi në rolin e gazetarëve të Kuvendit. Në grupin tonë diskutuam për demokracinë dhe zgjedhjet. Ky artikull ka të bëjë pikërisht me temat, të cilat i kemi diskutuar

Demokracia do të thotë udhëheqje e popullit. Zgjedhjet e lira janë themeli i demokracisë, sepse me anë të këtij procesi, populli zgjedh përfaqësuesit e vet. Këta përfaqësues janë deputetët, të cilët marrin vendime shumë të rëndësishme për neve. Të drejtën për t'i votuar këta përfaqësues e kanë të gjithë ata qytetarë të cilët i kanë 18 vjet e tutje.

Ne si fëmijë hasim në shumë situata, ku duhet të zgjedhim diçka që neve na pëlqen. Për shembull, shpeshherë në lëndën e edukatës fizike kemi mundësinë të zgjedhim lojën që dëshirojmë të luajmë. Kur ne zgjohemi në mëngjes, së pari zgjedhim rrobat që



dëshirojmë t'i veshim, pastaj edhe ushqimin që neve na pëlqen.

Pra, jemi të lirë të zgjedhim gjërat që neve na pëlqejnë më së shumti. Në demokraci, edhe pse jemi të lirë të zgjedhim, na takon neve të jemi të përgjegjshëm dhe të respektojmë njëri-tjetrin. Vetëm në këtë mënyrë sigurojmë të ardhmen e zhvillimit demokratik.



Ne e kemi të drejtën për të luajtur lojën që e pëlqejmë



Gazetarët e ardhshëm



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fehmi Agani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë